



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr.13, datë 14.10.2020


**PËR**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 20, DATË 23.10.2019 TË  
KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT “PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË  
ZBATIMIT TË PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE NË FUQI, PAS  
MIRATIMIT TË HARTËS SË PËRDITËSUAR TË KUFIJVE ADMINISTRATIVO-  
TERRITORIALË PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 360, datë 29.05.2019 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorialë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar dhe Vendimit Nr. 20, datë 23.10.2019 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për përcaktimin e mënyrës së zbatimit të planeve të përgjithshme vendore në fuqi, pas miratimit të hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorialë për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, me propozimin e Agjencisë Kombëtare për Planifikimin e Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Në Vendimin Nr. 20, datë 23.10.2019 të KKT-së “Për përcaktimin e mënyrës së zbatimit të planeve të përgjithshme vendore në fuqi, pas miratimit të hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorialë për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:
  - a) Pika 2, ndryshohet sipas formulimit të mëposhtëm:
    2. *Në njësitë e vetëqeverisjes vendore me Plan të Përgjithshëm Vendor të miratuar/ në fuqi sipas përcaktimeve të Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, për territoret e shtuara në administrimin e tyre, sipas hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorialë, administrimi i territorit*



*nëpërmjet përcaktimeve të Planeve të Përgjithshme Vendore, do të realizohet duke u bazuar në përcaktimet e PPV-së në fuqi të bashkisë kufitare.*

b) Pika 3, ndryshohet sipas formulimit të mëposhtëm:

*3. Në njësitë e vetëqeverisjes vendore pa Plan të Përgjithshëm Vendor të miratuar/ në fuqi sipas përcaktimeve të Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, për territoret e shtuara në administrimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore sipas hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorialë, administrimi i territorit do të realizohet duke u bazuar në përcaktimet e Vendimit Nr. 1, të KKT-së, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore”, i ndryshuar.*

c) Pas pikës 3, shtohet pika 3/1 me përmbajtje si më poshtë:

*3/1. Në njësitë e vetëqeverisjes vendore me Plan të Përgjithshëm Vendor të miratuar/ në fuqi sipas përcaktimeve të Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, për territoret e shtuara në administrimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore, sipas hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorialë, të cilat nuk rezultojnë të planifikuara nga PPV-të në fuqi të bashkive kufitare, administrimi i territorit do të realizohet duke u bazuar në përcaktimet e Vendimit Nr. 1, të KKT-së, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore”, i ndryshuar.*

d) Pika 4, ndryshohet sipas formulimit të mëposhtëm:

- 4. Përcaktimet e pikës 2 dhe 3/1 të këtij vendimi, gjejnë zbatim deri në momentin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë që ka përfutur territorin e shtuar në administrim të saj.*
2. Ngarkohen Autoritetet Vendore të bashkërendojnë punën me AKPT-në dhe AZHT-në gjatë procesit të zbatimit të Planeve të Përgjithshme Vendore, sipas përcaktimeve të këtij Vendimi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

